

VENDIM
Nr.420, datë 2.7.2004

**PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË, TË
INTERESUAR PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË “ARMO” SHA, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të “Armo” sh.a., Fier”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forma e përzgjedhjes së investorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të “Armo” sh.a., Fier, të jetë tender i hapur ndërkombëtar, me dy faza. Faza e parë të jetë “Shprehja e interesit”.

2. Pas fazës së parë të tenderit, ftesa për fazën e dytë t’u dërgohet vetëm kandidatëve që kanë shprehur interesin, duke përbushur kërkesat e përcaktuara në njoftimin publik, në përputhje me vendimin nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit për përzgjedhjen e investorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti, në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, si dhe kërkesat dhe afatet e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi.

3. Investitori strategjik i interesuar, që do të ftohet të paraqesë ofertën, duhet të përbushë, paraprakisht, kërkesat e mëposhtme:

a) Të jetë person juridik, që zotëron garanci financiare e të jetë i njohur me veprimtarinë ekonomike në një sektor të caktuar, në përputhje me standardet e certifikimit ISO 9 000 ose me standardet të njësuara me to.

b) Të ketë një kapital tërësisht të paguar, mbi 51 000 000 (pesëdhjetë e një milionë) USD apo barasvlerën e kësaj shume në valutën, në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe, sipas rastit, vlera neto e konsoliduar duhet të jetë të paktën 133 000 000 (njëqind e tridhjetë e tre milionë) USD.

c) Të jetë shoqëri e specializuar në fushën e përpunimit e të tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, e cila t’i ketë siguruar këto veprimtari për jo më pak se tre vjet; në rast të konsorciumeve apo të bashkimit të investorëve, anëtari kryesor të përbushë kërkesat e përmendura më lart.

Nuk do të pranohen në procedurën e tenderit palët, që janë në likuidim, që nuk kanë aftësi paguese ose kanë mbingarkesë në borxhe.

Në rastin e bashkimit të shoqërive për t’u paraqitur si palë e vetme për blerjen e aksioneve, investitori strategjik duhet të ketë kontrollin e bashkimit.

4. Kërkesa të vërtetohet me certifikatat zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse ose me dokumente të tjera, të shkruara, zyrtare.

5. Pas analizës së “Shprehjes së interesit” dhe pas verifikimit për përbushjen e kërkesave të mësipërme prej investorëve të interesuar, shoqëria këshilluese t’i paraqesë, për miratim, Komitetit të Konsulencës dhe të Transparencës listën e investorëve, të cilëve do t’u dërgohet ftesa për tender.

6. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë që, në përputhje me kapitullin II të vendimit nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti, në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe me kriteret e përcaktuara në këtë vendim, të nxjerrë, me urdhër, ftesën për “Shprehjen e interesit”.

7. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

